

Emri i Lëndës : Filozofi e së Drejtës							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 108	A	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Gjergji Sinani, Prof. Dr.					
Asistenti		Fioralba Markja, Msc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Filozofia e së drejtës kërkon t'i japë studentit njohuri bazë të jurisprudencës, duke prezantuar studentin me shkollat më të rëndësishme të jurisprudencës si dhe me karakteristikat dhe dallimet përkatëse mes tyre. Kursi gjithashtu analizon koncepte themelore ligjore si drejtësia, ligji, morali, etika etj.					
Objektivat		Të njohin bazat filozofike të së drejtës. Të kuptojnë teoritë kryesore juridike dhe morale. Të zhvillojnë analizë kritike mbi konceptet e drejtësisë. Të aplikojnë filozofinë në interpretimin e ligjit. Të forcojnë qëndrime etike dhe reflektuese në profesionin juridik.					
Konceptet Kryesore		1. Jurisprudenca 2. E drejta natyrore 3. Prozitivizmi ligjor 4. Kontrata Sociale 5. Utilitarizmi 6. Realizmi ligjor					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Hyrje e përgjithshme në filozofinë e së drejtës Tema hyrëse e lëndës e cila bën një trajtim të përgjithshëm të filozofisë së ligjit duke dhënë disa përkufizime mbi të, dukë identifikuar çështjet që mbulon lënda si dhe rolin dhe vendin që mban kjo lëndë në sistemin tonë ligjor. Gjithashtu, ndalet në disa terma të rëndësishme dhe të nevojshme për studentët në vazhdim të lëndës. (Fq. 12-26)					
2		Teoria e së drejtës natyrore Ky leksion shqyrton me detaje teorinë e parë kryesore të së drejtës që është e drejta natyrore duke e analizuar atë që në zanafillën e saj dhe duke dhënë karakteristikat e saj kryesore dhe dy drejtimet që ka ndjekur, konkretisht teorine teologjike dhe laike. (Fq. 27-37)					
3		Zhvillimi historik i së drejtës natyrore Zhvillimi historik i së drejtës natyrore analizohet që nga fillimet e hershme duke kaluar tek periudha klasike, periudha mesjetare dhe më pas tek hapat e parë drejt laicizmit të kësaj teorie. Krahas këtyre, trajtohet edhe raporti mes të drejtës natyrore dhe kontratës sociale. Në përfundim jepen vlerësime dhe kritika të teorisë nga autorë të ndryshëm. (Fq. 37-83)					
4		Pozitivizmi ligjor: Xhon Ostini dhe Bentami Kjo temë trajton teorinë e cila lindi si një kundërshtim i së drejtës natyrore duke shqyrtuar origjinat e pozitivizmit ligjor dhe duke dhënë karakteristikat e saj. Një vëmendje e vecantë i kushtohet qëndrimit të autorëve si Bentami dhe Ostini të cilët kontribuan në formulimin e kësaj teorie. Gjithashtu, jepen disa kritika mbi teorinë e Ostinit duke vënë në pah disa nga problemet që ajo kishte. (Fq. 84-123)					
5		Pozitivizmi ligjor modern: Harti Në vazhdim të kritikave mbi pozitivimin ligjor u themelua teoria e pozitivizmit ligjor modern e përfaqësuar nga Harti i cili shfaq qendrimin e tij lidhur me raportin e drejtë-sanksion të analizuar nga Ostini dhe raportin e drejtë-moral të analizuar nga përfaqësuesit e së drejtës natyrore. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 124-142)					
6		Rilindja e koncepteve të së drejtës natyrore: Lon Fuller Teoria e Fullerit u shfaq si një ridimensionim i së drejtës natyrore. Në këtë leksion do të trajtohen parimet procedurale të formuluar nga Fulleri të cilat sillnin edhe moralin procedural si një koncept i ri që shfaqej në jurisprudencë. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 143-184)					

7	Teoria e kulluar e së drejtës (Hans Kelzen) Ky leksion ndalet tek teoria e kulluar e së drejtës duke përcaktuar metodologjinë e ndjekur nga Kelzeni dhe piramidën e burimeve të së drejtës duke sqaruar edhe hierarkinë mes këtyre burimeve. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 185-209)
8	Provimi gjysmë final
9	Teoria e Dvorkinit për të drejtën dhe moralin Tema analizon pozicionin e Dvorkinit mbi teoritë ekzistuese si e drejta natyrore dhe pozitivizmi ligjor. Gjithashtu trajton parimet e Dvorkinit duke sqaruar secilin prej tyre. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 210-229)
10	Utilitarizmi: Bentami dhe Mill Utilitarizmi i përfaqësuar nga Bentami dhe Milli është gjithashtu një nga teoritë më të rëndësishme të së drejtës. Ky leksion jep karakteristikat e utilitarizmit duke dhënë dhe raste konkrete të zbatimit të kësaj teorie. Krahas kësaj, sqarohen dhe disa dallime që gjenden në qëndrimet e dy përfaqësuesve të kësaj teorie, Bentami dhe Milli. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 281-295)
11	Realizmi ligjor amerikan dhe skandinav Ky leksion trajton ndikimin e realizmit ligjor amerikan dhe skandinav në sistemet ligjore të këtyre vendeve duke përcaktuar edhe karakteristikat e tyre. (Fq. 260-280)
12	Teoria e Drejtësisë (Rolls) Teoria e Drejtësisë e përfaqësuar nga Rollsi pati po ashtu një kontribut të madh në lëmin e teorisë së së drejtës. Në këtë leksion trajtohet përkufizimi i jep Rollsi drejtësisë si dhe metodat që ai ndjek për të realizuar drejtësinë në shoqëri. Në përfundim jepen disa vlerësime dhe kritika mbi këtë teori. (Fq. 347-365)
13	Cështje të debatueshme të filozofisë të së drejtës Ky leksion synon të adresojë disa cështje që janë objekt diskutimi në filozofinë e së drejtës. (Fq. 366-378)
14	Teoritë kritike moderne Ky leksion ndalet tek rryma e studimeve ligjore kritike dhe jurisprudenca feministe si një nga teoritë që solli risi në studimin e së drejtës. Krahas kësaj, trajtohet ndikimi që ka patur jurisprudenca feministe në reformimin e së drejtës. (Fq. 303-322)
15	Përsëritje
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • 1. Luljeta Ikononi, Filozofia e së drejtës (Tiranë: Onufri 2010)	
Referenca të tjera • 1. M.D.A Freeman, Lloyd's Introduction to Jurisprudence (London: Sweet&Maxwell 2008) 2. Raymond Wracs, Understanding Jurisprudence (Oxford: Oxford University Press 2012) 3. Larry May and Jeff Brown, eds. Philosophy of Law: Classic and Contemporary Readings (Oxford: Wiley-Blackwell 2010)	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Kuptimi i marrëdhënies midis së drejtës dhe shoqërisë në aspektin e natyrës, zbatimit dhe qëllimit të së drejtës.
2	Dallimi mes së drejtës, moralit dhe drejtësisë si dhe përkufizimi i ligjit dhe efektivitetit të tij në lidhje me imperativët e tjerë sociologjikë dhe metafizikë.
3	Konceptimi i marrëdhënieve mes ligjit, aktorëve të tij dhe ndryshimeve shoqërore.
4	Zhvillimi i aftësive kritike dhe argumentuese të studentëve.
5	Përgatitja e studentëve për t'u bërë pjesë e diskutimeve të frytshme në fushën e jurisprudencës.
6	Pajisja e studentëve me terminologjinë e mjaftueshme ligjore për të vijuar me lëndët e tjera pasardhëse.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	1	1
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			119
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.76
ECTS			5.00